

## SILABUS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Departamenti i Kimisë / FSHMN</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Elektrokimia</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Orari del në tabelën e shpalljeve / Departamenti i Kimisë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Dr. Ramë VATAJ</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Email: <a href="mailto:rame.vataj@uni-pr.edu">rame.vataj@uni-pr.edu</a> Tel (mobil): 044 139 763</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Në këtë kurs mësohen bazat teorike të elektrokimisë, duke filluar nga proceset fiziko-kimike që ndodhin në ndërfaqen tretësirë – elektrodë, Ligjet e Faraday-it, termodinamika elektrokimike, kinetika elektrokimike, mandej metodat elektrokimike më të zakonshme dhe disa specifike për studimin e materialeve dhe shtresave të depozituara, duke përfunduar me bateritë, llojet e tyre dhe përdorimin e elektrokimisë në industri.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Moduli është përgatitur me qëllim të njohjes së studentëve të cilët kanë përfunduar qoftë programin e kimisë arsimore apo inxhinierisë kimike, me të dhënat fundamentale teorike dhe praktike të përdorimit të elektrokimisë. Studentët do të mësojnë për teknikat elektrokimike të cilat mund të përdoren në studimin e materialeve të ndryshme, ose edhe në studime analitike cilësore dhe sasiore. Poashtu do të mësojnë edhe për burimet kimike të energjisë – bateritë dhe llojet e tyre, dhe përdorimin e elektrokimisë në nivel industrial.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptoi dhe të ketë njohuritë elementare të elektrokimisë.</li> <li>• Të ketë njohuritë elementare mbi proceset të cilat zhvillohen në elektroda, mekanizmin e zhvillimit të këtyre proceseve dhe ekuacionet që lidhen me këto procese.</li> <li>• Përdorë metodat elektrokimike në studimin e sipërfaqes së materialeve, dhe për qëllime tjera analitike.</li> <li>• Të dijë të interpretojë lakoret rrymë-potencial. Në bazë të llojit të voltamogramit, të dallojë për cilën teknikë bëhte fjalë.</li> <li>• Të njohë teknikat moderne elektrokimike dhe të dijë përparësitë dhe mangësitë në raport me njëra tjetrën dhe në raport me metodat tjera fiziko kimike (psh. metoda spektroskopike).</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet, etj			
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	ligjërata, seminare, diskutime, punë në grupe.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë:	15 %	
	Vlerësimi i dytë	15 %	

	Angazhimi në ushtrime 15 % Vijimi i rregullt 5 % Provimi final 50 % Total 100 %
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	1. T. F. Fuller, J. N. Harb, Electrochemical engineering, John Wiley & Sons, Inc (2018).
<b>Literatura shtesë:</b>	1. K. B. Oldham, J. C. Myland, and A. B. Bond, Electrochemical Science and Technology: fundamentals and applications, John Wiley & Sons, Ltd (2012). 2. A. Bard, L. Faulkner, H. S. White, Electrochemical Methods, Fundamentals and Applications, Third edition, John Wiley & Sons, Ltd (2022).
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në elektrokimi. Nocionet themelore në elektrokimi, potenciali elektrik, oksido-reduktimi, gjysëm-reaksionet redoks. Celulat elektrokimike, llojet e tyre, reaksionet në elektroda.
<i>Java e dytë:</i>	Ligjet e Faraday-it. Proceset faradike dhe jofaradike. Faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve elektrodike te proceset faradike. Sistemet elektrokimike.
<i>Java e tretë:</i>	Termodinamika elektrokimike, potenciali i celulave elektrokimike. Energjia e lirë e Gibbs-it dhe forca elektromotore. Ekuacioni i Nernst-it. Llojet e potencialeve në sistemet elektrokimike dhe diferenca dhe ekuilibri i potencialit në ndërfaqen elektrodë-tretësirë.
<i>Java e katërt:</i>	Kinetika elektrokimike. Ndikimi i potencialit në shpejtësinë e reaksionit. Ekuacioni i Butler-Volmer-it. Ndikimi i transferit të masës në shpejtësinë e reaksionit në elektroda.
<i>Java e pestë:</i>	Metodat elektrokimike, klasifikimi i tyre dhe përdorimi i tyre në analizën e sistemeve elektrokimike. Nocionet themelore në elektrokiminë dinamike. Lakoret rrymë-potencial, origjina, leximi dhe aplikimi në sistemet elektrokimike.
<i>Java e gjashtë:</i>	Polarografia, Voltmetria impulsive diferenciale (DPV), Voltmetria me valë katrore (SWV).
<i>Java e shtatë:</i>	Voltmetria ciklike (CV). Voltmetria me zhveshje të elektrodës. Voltmetria me elektrodë rrotulluese (RDE).
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi i parë i studentëve
<i>Java e nëntë:</i>	Metodat kulometrike, elektroliza.

<i>Java e dhjetë:</i>	Shtresat elektroaktive dhe elektrodën e modifikuara.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Mikroskopia elektrokimike me skanim (SECM). Mikrobalanca me kristal të kuarcit (QCM). Spektroelektrokimia UV-VIS.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Bateritë, ndarja, vetitë, përdorimi i tyre.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Bateritë me lëndë djegëse.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Elektroliza industriale, Reaktorët elektrokimik.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë
<b>Plani i dizajnuar i ushtrimeve:</b>	
<b>Ushtrimet që do të zhvillohen</b>	
<i>Java e parë:</i>	Celulat elektrokimike (konstruktimi Elementit të Danielit, matja e FEM)
<i>Java e dytë:</i>	Mbipotenciali. Elektroliza e ujit
<i>Java e tretë:</i>	Matja e koeficientit të difuzionit të një substance elektroaktive ( $Fe^{3+}/Fe^{2+}$ ).
<i>Java e katërt:</i>	Voltametria lineare e tretësirës së ferricianurës së kaliumit në elektrodë rrotulluese dhe statike.
<i>Java e pestë:</i>	Fitimi i drejtëzave të Tafel-it për një çift redoks.
<i>Java e gjashtë dhe e shtatë:</i>	Voltametria pulsive diferenciale e tretësirës ujore të ferricianurës së kaliumit dhe analizimi i rezultateve të fituara.
<i>Java e tetë dhe e nëntë:</i>	Voltametria ciklike e tretësirës ujore të ferricianurës së kaliumit dhe analizimi i voltamogramit të fituar.
<i>Java e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë:</i>	Studimi i shkallëve të reaksionit redoks me voltometri ciklike.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Efekti i adsorbimit të acideve n-alkanoike në inhibimin e korrozionit të hekurit, me teknikën e LSV.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përfitimi elektrokimik i klorit në shkallë të vogël (elektroliza e KCl në elektrodën e grafitit).
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sinteza elektro-organike (përfitimi i polimerëve përçues nga polimerizimi i anilinës).
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Evalumi i studentëve</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrimet dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.



<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>FSHMN: Departmenti i Kimisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Energjia e qëndrueshme dhe materialet</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master – Inxhinieria dhe shkenca e materialeve</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II dytë / Semestri i III</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E Enjëte, 12<sup>30</sup>-14<sup>00</sup></b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Flamur SOPAJ</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Email: flamur.sopaj@uni-pr.edu</b> <b>Tel: 049-386-931</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Rritja e kërkesës globale për energji kërkon gjetjen e alternativave ndaj burimeve fosile. Kërkesa për burime të energjive natyrore (diellore me fotovoltaike, erë, hidrodinamike...) është në rritje. Prandaj, është e nevojshme të bashkohen këto burime me sisteme që lejojnë riciklimin dhe ruajtjen e këtyre energjive të tilla si bateritë dhe superkondensatorët. Kufizimet mjedisore çojnë në zhvillimin e sistemeve të pastra të ruajtjes së energjisë, siç janë celulat me karburant. Megjithatë, është koha për të ndaluar këtë garë drejt gjithnjë e më shumë të madhe drejt energjisë dhe për të fokusuar në kursimin e enrgjisë. Në këtë modul, do të diskutohet se cilat materiale mund të përdoren për të ruajtur dhe ricikluar energjinë për sistemet e ndryshme të lartpërmendura.</p> <p>Për secilën prej tyre do të trajtohen teknologjitë egzistuese, qasjet e reja dhe sfidat mjedisore.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>T'u ofroj studentëve njohuri në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë problemet mjedisore nga burimet e energjisë. Pastaj të njohin materialet dhe sitemet për ruajtjen e energjisë, të tilla si bateritë dhe celulat me karburant.</p> <p>Të zhvillojë shkathtësi në llogaritje, përdorim dhe aplikim të sistemeve të pastrë të prodhimit dhe ruajtjes së energjisë.</p>

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojë fenomenet që ndodhin brenda baterive.</li> <li>• Njohin sinjalet karakteristike të një pajisjeje energjiruajtëse si funksion i proceseve kimike që ndodhin në të.</li> <li>• Llogarisin energjinë dhe fuqinë e dhënë nga rezultatet e provave klasike elektrokimike.</li> <li>• Të dinë të lidhin bateritë në bashkësi ër të rritur tensionin dhe kapacitetin.</li> <li>• Përshtasin një pajisje energjiruajtëse në funksion të kërkesave të aplikimt.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	5	10
Projektet, prezentimet ,etj	1	10	10
<b>Totali</b>	<b>17</b>	<b>80</b>	<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata (metoda interaktive dhe monolog), punim seminarik, ushtrime praktike dhe numerike, diskutim, punë në grupe.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime 10 %</li> <li>• Punimi seminarik 20 %</li> </ul>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vijimi i rregullt 10 %</li> <li>• Provimi final (me shkrim) 60 %</li> </ul>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Alfred Rufer. <i>Energy Storage</i> . Taylor & Francis Group, LLC, 2018.
<b>Literatura shtesë:</b>	John Twidell, Tony Weir. <i>Renewable Energy Resources</i> . 2-nd edition, Taylor & Francis 2 Park Square, Milton Park, Abingdon, 2006.
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Burimet e ripërtërijshme të energjisë.
<i>Java e dytë:</i>	Sistemet e ruajtjes së energjisë.
<i>Java e tretë:</i>	Vetitë dhe krahasimi is sistemeve të ruajtjes së energjisë.
<i>Java e katërt:</i>	Burimet elektrokimike të energjisë. Akumulatorët.
<i>Java e pestë:</i>	Modelimi i baterive.
<i>Java e gjashtë:</i>	Sistemet e menagjimit të baterive. Vjetrimi i baterive.
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Vlerësimi i parë intermediar</b>
<i>Java e tetë:</i>	Ruajtja e energjisë në superkapacitor.
<i>Java e nëntë:</i>	Modelimi, dizajni, ngarkimi dhe shkarkimi.
<i>Java e dhjetë:</i>	Konvertuesit elektronikë të energjisë. Shembuj të aplikimit të superkapacitorëve.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Celulat me karburant, përdorimi i hidrogjenit për ruajtjen e energjisë.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përdorimi i hidrogjenit për ruajtjen e energjisë.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Organizimi i sistemit dhe aplikimet.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Punim seminarik- prezantojnë studentët.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Vlerësimi i dytë intermediar</b>
<b>Java</b>	<b>Ushtrimet</b>
<i>Java e parë</i>	Ushtrime numerike nga elektrokimia.
<i>Java e dytë</i>	Ndërtimi dhe matja e parametrave të një celule galvanike.
<i>Java e tretë</i>	Përdorimi i multimetrava.
<i>Java e katërt</i>	Prerja dhe naliza e një baterie plumb/acid.
<i>Java e pestë</i>	Prerja dhe analiza e komponenteve të baterive të ndryshme.
<i>Java e gjashtë</i>	Matja e tensionit dhe rymës së baterive dhe diskutimi i të dhënave të fituara nga bateritë e ndryshme.
<i>Java e shtatë</i>	Ushtrime numerike nga bateritë.
<i>Java e tetë</i>	Ndërtimi dhe testimi i një baterie.
<i>Java e nëntë</i>	Prerja dhe analiza e komponenteve të një superkapacitori.

<i>Java e dhjetë</i>	Modelimi, vlerësimi dhe simulimi i një superkapacitori.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Ndërtimi dhe testimi i një konvertuesi dydrejtimësh.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Ushtrime numerike nga superkapacitorët.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Përgatitja dhe studimi i një celule karburanti.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Përgatitja e një celule me karburant dhe përdorimi për shkatërrimin e ndotësve organikë në ujë.
<i>Java e pesmbëdhjetë</i>	Ushtrime numerike nga celulat me karburant.

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve duhet të jetë i rregullt. Kërkohet disipline maksimale dhe respektim të rregullave të sjelljes akademike. Për specifikën e organizimit të ligjëratave dhe ushtrimeve studentët njoftohen me kohë nga ligjëruesi i lëndës.

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>FSHMN: Departmenti i Kimisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Kimi fizike dhe formulimet</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master – Inxhinieria dhe shkenca e materialeve</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II parë / Semestri i II</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E Enjëte, 12<sup>30</sup>-14<sup>00</sup></b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Flamur SOPAJ</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Email: flamur.sopaj@uni-pr.edu</b> <b>Tel: 049-386-931</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Në këtë lëndë prezantohen konceptet e nevojshme për të kuptuar sistemet komplekse të formuluar të dispersioneve koloidale, sipërfaqeve/ndërfaqeve dhe sistemeve të vetëorganizuara që janë pjesë e materies së butë. Qasja e përshkallëzuar do të mundësoi kuptimin e asaj se si kontrolli i ndërveprimeve që ndodhin në ndërfaqe shpesh përcakton vetitë e sistemeve të shpërndara.</p> <p>Ky kurs është i dedikuar për studentët e interesuar në bazat shkencore dhe teknike të formulimit të lëndës së butë. Zbatohet në kozmetologji, farmaceutikë, përpunim të produkteve ushqimeve, naftë, detergjentë, bitum dhe materiale në përgjithësi.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Pas përfundimit të kursit, studenti duhet të jetë në gjendje të identifikojë aspektet shkencore të një recete për formulimin e një sistemi kompleks (parimet e ndërveprimeve në shkallë koloidale, metodat e përzierjes dhe stabilizimit).</p> <p>Ai duhet të zotëroi fenomenet fizike, veçanërisht ato në shkallë mezoskopike që e lejojnë atë të kalojë nga njohuritë e tij si kimist në zhvillimin e sistemeve komplekse industriale.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohin konceptet themelore mbi</li> </ul>

	<p>koloidet dhe materien e butë në përgjithësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohin dhe të shpjegojnë dukuritë që ndodhin në fazat dhe ndërfaqet.</li> <li>• Të përdorin këto njohuri për të ndërhyrë në sistemet a materies së butë, me qëllim ndryshimit të vetive të sajë sipas kërkesës.</li> <li>• Të sintetizojnë dhe karakterizojnë sisteme të materies së butë.</li> <li>• Të përgatisin shembuj të formulimeve nga fushat e ndryshme si: farmacia, produktet ushqimore, detergjentët, mjedisi, ngjyrat, kozmetika ose industria në përgjithësi.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	5	10
Projektet, prezentimet ,etj	1	10	10
<b>Totali</b>	<b>17</b>	<b>80</b>	<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata (metoda interaktive dhe monolog), punim seminarik, ushtrime praktike dhe numerike, diskutim, punë në grupe.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	• Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime 10 %		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punimi seminarik 20 %</li> <li>• Vijimi i rregullt 10 %</li> <li>• Provimi final (me shkrim) 60 %</li> </ul>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Hans Mollet, Arnold Grubenmann. <i>Formulation Technology - Emulsions, Suspensions, Solid Forms</i> . 1-st edition, WILEY-VCH Verlag GmbH, 2001.
<b>Literatura shtesë:</b>	Drew Myers. <i>Surfaces, Interfaces, and Colloids</i> . 2-nd edition, John Wiley & Sons, Inc. 1999.
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Koloidet, fazat, dhe ndërfaqet.
<i>Java e dytë:</i>	Emulsionet, vetitë dhe përdorimi.
<i>Java e tretë:</i>	Microemulsionet, fluskat dhe lipozomet. Shkumat.
<i>Java e katërt:</i>	Prodhimi dhe vetitë e suspensioneve dhe dispersioneve koloidale.
<i>Java e pestë:</i>	Prodhimi dhe vetitë e suspensioneve dhe dispersioneve koloidale.
<i>Java e gjashtë:</i>	Format e nguta.
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Vlerësimi i parë intermediar</b>
<i>Java e tetë:</i>	Reologjia.
<i>Java e nëntë:</i>	Parametrat e tretshmërisë, Log P, LSER, numrat M.
<i>Java e dhjetë:</i>	Tretshmëria dhe kristalizimi.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Detergjentët. Kozmetika.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Teknologjia farmaceutike.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Formulimet ushqimore.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Formulimet agrikulturne. Pigmentet dhe Ngjyrat.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Vlerësimi i dytë intermediar</b>
<b>Java</b>	<b>Ushtrimet</b>
<i>Java e parë:</i>	Përgatitja e sistemeve koloidale me anë të disa metodave.
<i>Java e dytë:</i>	Përcaktimi i forcës koaguluese të disa elektrolitëve.
<i>Java e tretë:</i>	Koagulimi i proteinave me substanca të ndryshme koaguluese.
<i>Java e katërt:</i>	Përgatitja e soleve liofilike dhe liofobike dhe pastrimi i tyre me anë të dializës.
<i>Java e pestë:</i>	Pastrimi i sistemeve koloidale me anë të elektrodializës.
<i>Java e gjashtë:</i>	Ndikimi i agjentëve emulsifikues në stabilitetin e

	emulsioneve të disa vajrave.
<i>Java e shtatë:</i>	Matja e viskozitetit të disa sistemeve koloidale.
<i>Java e tetë:</i>	Izoterma e Gibbsit për adsorbimin e span në ndërfaqe.
<i>Java e nëntë:</i>	Izoterma e Gibbsit për adsorbimin e tween në ndërfaqe.
<i>Java e dhjetë:</i>	Matja e shtypjes osmotike të sistemeve koloidale.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Përgatitja e produkteve kozmetike dhe detergjentëve.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Përgatitja e produkteve ushqimore.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përgatitja e produkteve agrikulturore, ngjyrave dhe pigmenteve.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Polimerizimi i stirenit me anë të mekanizmit me radikale të lira duke përdorur 2,2'-Azobis(isobutyronitrile) (AIBN) si iniciues. Karakterizimi i sistemit koloidal të fituar.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Vizitë në industri të barnave dhe ushqimit.
<i>Java e pesmbëdhjetë:</i>	Vizitë në industri të detergjentëve.

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve duhet të jetë i rregullt. Kërkohet disiplinë maksimale dhe respektim të rregullave të sjelljes akademike. Për specifikën e organizimit të ligjëratave dhe ushtrimeve studentët njoftohen me kohë nga ligjëruesi i lëndës.

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>FSHMN, Departamenti i Kimisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Kimia fizike e polimerëve</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Rregullt</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E marte 10:30, Salla nr.2</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Dr. Bashkim Thaçi</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:bashkim.thaci@uni-pr.edu">bashkim.thaci@uni-pr.edu</a> , <a href="mailto:bthaqi75@gmail.com">bthaqi75@gmail.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Në këtë kurs përshkruhen efektet e strukturës dhe masës molekulare në vetit fiziko-kimike të polimereve. Fokusi kryesor do të jetë sçarimi i konformacionit të vargut, vetit mekanike, tranzicionin e qelqit, elasticitetin e gomës, termodinamikën e tretësirave polimerike, lëgjet kristalore, në metodat për përcaktimin e masës molare, në metodat për studimin e strukturës së polimerëve. etj.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i këtij kursi është të aftësojë studentët me konceptet moderne dhe vetive fiziko-kimike të molekulave polimerike dhe materialeve që përbëhen nga këta polimerë. Duke u nisur nga dimensionet karakteristike të monomerëve dhe duke kaluar nëpër vargjet dhe rrjetet e tyre, së bashku me tretësirat polimerike dhe materialet në gjendje të ngurtë. Studentët do të fitojnë njohuri bazë për këtë klasë të rëndësishme materialesh të përhapura në Biologji dhe industri.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fiton shkathtësi dhe përvijë të avancuar për interpretimin e konformacionit të vargut;</li> <li>• Interpreton ndërveprimet elektrostатike në tretësira të polimerike;</li> <li>• Shpjegon metodat për përcaktimin e masës</li> </ul>

	<p>molare: shtypja osmotike, sedimentim, viskozitet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpretimet e metodave të përfundimit dhe vetitë e lëngjeve kristalore;</li> <li>• Shpjegon proceset fazore dhe transformimet fazore të tretësirave polimerike.</li> <li>• Përgatit dhe teston filma të ndryshëm polimerik membranor.</li> <li>• Analizon strukturën e komponimeve të ndryshme, përkatësisht format e tyre e kështu zhvillon idenë për përfundimin e produkteve tjera të reja.</li> </ul>
--	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësve të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mesimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	3	7	21
Detyra të shtëpisë	3	3	9
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	9	27
Përgatitja përfundimtare për provim	3	7	21
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet ,etj	1	1	1
<b>Totali</b>			<b>150</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	ligjërata, konsultime, seminar, diskutim, ushtrime, detyra shtëpie.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi i rregullt – 5%; Angazhim në ligjërata - 5%;

	Vlerësimi i parë - 15%; Seminar – 15%; Vlerësimi i dytë - 15%, Vlerësimi në ushtrime 15%, Provimi final 30%. Notimi: 51 - 60 = 6; 61 - 70 = 7; 71 - 80 = 8; 81 - 90 = 9, dhe mbi 90 = 10.
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	1. Sebastian Seiffert, Physical Chemistry of Polymers: A Conceptual Introduction, De Gruyter, 2020.
<b>Literatura shtesë:</b>	2. Chin Han Chan, Chin Hua Chia, Sabu Thomas, Physical Chemistry of Macromolecules: Macro to Nanoscales, CRC Press Taylor & Francis Group 2014. 3. Gennady E Zaikov and Ryszard Kozłowski, Chemical And Physical Properties Of Polymers, Nova Science Publishers 2005. 4. S. F. Sun, St. John's University Jamaica, New York, Physical chemistry of macromolecules, 2004.
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Njoftimi i studentëve me syllabus. Makromolekulat, polimerët sintetik.
<i>Java e dytë:</i>	Sinteza e komponimeve polimerike. Polimerizimi, kopolimerizimi. Polikondenzimi.
<i>Java e tretë:</i>	Transformimet kimike të polimerëve. Rrotullimi i brendshëm i molekulës. Bariera e rrotullimit.
<i>Java e katërt:</i>	Termodinamika e tretësirave polimerike.
<i>Java e pestë:</i>	Konfiguracioni i vargut.
<i>Java e gjashtë:</i>	Lëngjet kristalore. Mesogjenet, lëngjet kristalore polimerike.
<i>Java e shtatë:</i>	Format e mezogjeneve. Fazat e lëngjeve kristalore. Lëngjet kristalore liotropike dhe termotropike.
<i>Java e tetë:</i>	Testi i parë
<i>Java e nëntë:</i>	Vizkoziteti dhe vizkoelasticiteti.
<i>Java e dhjetë:</i>	Shtypja osmotike. Përcaktimi i masës molekulare.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Difuzioni. Ligji i parë dhe i dytë i Fik-ut

<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Sedimentimi. Matja e koeficientit të sedimentimit.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Dispersioni i rrotullimit optikë. Gjendjet fazore dhe transformimet fazore të polimerëve.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Mikroskopia elektronike, Difraksioni i Rrezev- X, Difraksioni elektronik.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Testi i dytë

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.	
<b>Plani i dizajnuar i ushtrimeve:</b>	
<b>Ushtrimet që do të zhvillohet</b>	
Ndikimi i additive në vetitë termike të materialit polimerik	
Ndikimi i additive në rritjen e stabilitetit oksidues të materialeve polimerike.	
Përgatitja e qymyrit si material membranor	
Përgatitja e tretësirës polimerike acetat celuloze –qymyr	
Shtrirja e filmit polimerik membranor	
Testimi i membranave me sistem standard: NaCl –H <sub>2</sub> O.	
Kollokviumi i parë	
Testimi i membranave me sistemet: NaF, CdSO <sub>4</sub> .	
Testimi i membranave me sistemet: Na <sub>2</sub> SO <sub>4</sub> , Na <sub>3</sub> PO <sub>4</sub> .	
Përcaktimi i karakterisikave të membranave nga polisulfonet	
Përcaktimi i karakterisikave të membranave nga poliamidet aromatike	
Përcaktimi i masës molekulare të polistirenit me vizkozimetër	
Përcaktimi i masës molekulare të tretësirës polimerike nga shtypja osmotike.	

Kollokviumi i dytë

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Departmenti i Kimisë, FSHMN</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Kimia Inorganike; prej molekulave te materialet</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master - drejtimi Kimi fizike dhe inorganike</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Semestri i I<sup>(rë)</sup></b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Orari sipas shpalljes nga Departamenti i Kimisë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Dr. sci. Albana Mehmeti (prof.asoc)</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Email:<a href="mailto:albana.mehmeti@uni-pr.edu">albana.mehmeti@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Ky modul është kombinim: i të kuptuarit të materialeve që mund të definohen si përbërje e gjendjes së ngurtë ose pjesëza që mund të përdoren për çdo gjë, dhe studim i avancuar inorganik i simetrisë, strukturës, lidhjes kimike të këtyre përbërjeve. Kjo përbërje mund të jetë mineralore, elemente kalimtare apo lantanide, prandaj do të shtjellohen edhe vetitë optike dhe magnetike, si edhe përdorimi i tyre industrial.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Që si disiplinë shkencore të lehtësoj të kuptuarit e organizimit apo ndërtimit të atomeve, joneve dhe molekulave brenda një materiali si edhe të shpjegoj vetitë dhe strukturat e tyre qofshin ato materiale natyrore apo sintetike, minerale, elemente kalimtare apo lantanide. Si edhe të kuptohet rëndësia e tyre shkencore dhe aplikimi i tyre industrial.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojnë të arriturat e avancuara teorike, mësojnë interpretimin e lidhjes dhe reaktivitetin në komponimet inorganike.</li> <li>• Të interesohen në fushën e hulumtimit industrial.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ti njohin strukturat dhe vetitë e disa mineraleve më të përdorura industriale .</li> <li>• Të mësojnë pse është rritur përdorimi i tyre në industrinë botërore?!</li> <li>• Ti kuptojnë disa veti optike dhe magnetike të elementeve kalimtare dhe të Lantanideve.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjerata	2	2/ 15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2/15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2/15	30
<b>Totali</b>	<b>6</b>	<b>6/15</b>	<b>90</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjerata (shpjegim dhe interakcion), punim seminarik, ushtrime eksperimentale dhe diskutim, punë në individuale dhe grupe,		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime 10 %</li> <li>• Punimi seminarik 20 %</li> <li>• Testi final 10 %</li> <li>• Provimi final (me shkrim) 60 %</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	1. F. Cotton A., Wilkinson G., F.R.S: Advanced Inorganic Chemistry (A comprehensive text)		
<b>Literatura shtesë:</b>	2. Saito T. : Inorganic Molecules 3. Allcock H.R Introdutin to Materials Chemistry;		
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>			
	<b>Ligjeratat</b>		
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në kiminë e materialeve		
<i>Java e dytë:</i>	Simetria dhe strukturat		
<i>Java e tretë:</i>	Ngurtësirat jonike dhe vargjet tjera të zgjëruara.		
<i>Java e katërt</i>	Defektet dhe papastërtitë në ngurtësira		
<i>Java e pestë:</i>	Natyra e lidhjes kimike		
<i>Java e gjashtë:</i>	Lidhjet dhe strukturat		

<i>Java e shtatë:</i>	Difuzioni, temperatura dhe faktorët që e ndikojnë difuzionin
<i>Java e tetë:</i>	Strukturat silikate
<i>Java e nëntë:</i>	Mineralet industriale dhe strukturat
<i>Java e dhjetë:</i>	Modifikimi i sipërfaqes së mineralit.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Elementet kalimtare, strukturat elektronike dhe karakteristikat
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vetitë magnetike dhe rëndësia e magnetizmit në elementet kalimtare
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Vetitë optike dhe magnetike të komponimeve koordinative
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Vetitë optike të Lantanideve në fazën e kondenzuar, teori dhe aplikim
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Testi para provimit.</b>
	<b>Ushtrimet (laboratorike, teorike)</b>
<i>Java e parë:</i>	Përcaktimi dhe studimi i strukturës kristalore
<i>Java e dytë:</i>	Përcaktimi dhe studimi i defekteve në strukturën kristalore
<i>Java e tretë:</i>	Studimi i strukturave të metaleve /aliazheve
<i>Java e katërt</i>	Trajtimi termik (forcimi dhe kalitja) e përbërjes së hekurit
<i>Java e pestë:</i>	Mekanizmi i korrozionit kimik dhe mbrojtja
<i>Java e gjashtë:</i>	Struktura e hekurit të trajtuar termikisht
<i>Java e shtatë:</i>	Përgaditja e lakores së ngurtësimit të përbërjes së caktuar
<i>Java e tetë:</i>	Studimi material i termo plastikës
<i>Java e nëntë:</i>	Studimi i llojeve të ndryshme të plastikës
<i>Java e dhjetë:</i>	Studimi i grilave Bravais me ndihmën e modeleve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Deformimi i kristaleve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Studimi i strukturave dhe defekteve kristalore me ndihmën e modeleve sfera (ball models)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Studimi i fërkimit gjatë procesit të formimit të metalit
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Rekapitullim (pyetje përgjegje) të ushtrimeve më lartë
<b>Java e pesëmbëdhjetë</b>	Përgaditjet për provim!

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijimi i ligjeratave dhe ushtrimeve duhet të jetë i rregullt. Studentët duhet t'i respektojnë politikat themelore të lëndës. Me fillimin e kursit studentët do të informohen për rregullat specifike, detajet e mësimin dhe aktivitetet mësimore dhe vlerësimin në bazë të tyre.

## Formular për SYLLABUS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>FSHMN- Departamenti i Kimisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Kinetika e proceseve në materiale</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E Hënë/ 12:30-14:00</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Ass. Makfire Sadiku</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:makfire.sadiku@uni-pr.edu">makfire.sadiku@uni-pr.edu</a>; 044-166-499</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Përkufizimet e termave kinetikë: shpejtësia e reagimit dhe formimit. Ligjet e shpejtësisë, diferenciale dhe forma e integruar. Përcaktimi i rendit dhe shpejtësisë së reaksionit nga të dhënat eksperimentale. Teknikat eksperimentale për monitorimin e shpejtësisë së reaksioneve.</p> <p>Ky kurs është një prezantim i koncepteve kinetike themelore dhe universale, si teoria e difuzionit dhe shpejtësisë së reaksionit.</p> <p>Proceset kinetike gaz-ngurtë,, lëngët-ngurtë dhe, ngurtë-ngurtë dhe kinetika e disa reaksioneve të veçanta.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kursit është zhvillimi i kuptimit konceptual dhe sasior të shpejtësisë së reaksioneve kimike dhe hulumtimi i përshkrimit sasior të shpejtësisë së reaksionit.</p> <p>Ky kurs synon gjithashtu të jetë një hyrje e arritshme në konceptet dhe parimet kryesore që mbështesin proceset kinetike në sistemet e materialeve.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët duhet të:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Definojnë rendin e reaksionit dhe të japin shembuj të reaksioneve të rendit të parë dhe të dytë. Zhvillojnë ekuacionin e përgjithshëm të shpejtësisë së aktivizuar (raportin Arrhenius) që përshkruan se si shpejtësia e reaksionit ndryshon me temperaturën.</li></ol>

	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Aplikojnë modele të shpejtësisë së reaksionit kinetik për të parashikuar ecurinë e reaksioneve të thjeshta të rendit të parë dhe të dytë.</li> <li>3. Zbatojnë ekuacionet kinetike të shpejtësisë së reaksionit për të parashikuar se si ndryshojnë shpejtësitë e reagimit me temperaturën, presionin dhe përqendrimin.</li> <li>4. Krahasojnë dhe dallojnë proceset e difuzionit të gazeve, lëngjeve dhe gjendjes së ngurtë. Parashikojnë dhe modelojnë (në mënyrë sasiore) proceset e difuzionit në të tri fazat e materies.</li> <li>5. Shpjegojnë mekanizmat atomistikë të difuzionit në fazë të gazit dhe të ngurtë.</li> </ol>
--	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	3	6
<b>Totali</b>			<b>150</b>

**Metodologjia e mësimdhënies:**

	Ligjërata, ushtrime numerike, ushtrime laboratorike
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë: 15%, Vlerësimi i dytë: 15 %, Angazhimi në ushtrime: 15 %, Vijimi i rregullt: 5 %, Testi final: 35%, Total 100%
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<i>Han-Il Yoo, Lectures on Kinetic Processes in Materials</i> , Springer Nature Switzerland AG, 2020.  <b>Robert W. Balluffi, Samuel M. Allen, W. Craig Carte, Kinetics of Materials</b> , John Wiley & Sons, Inc., Hoboken, New Jersey, 2005.  <b>RYAN O'HAYR, Material Kinetics Fundamentals</b> , John Wiley & Sons, Inc., Hoboken, New Jersey, 2015.
<b>Literatura shtesë:</b>	
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në kinetikën e materialeve
<i>Java e dytë:</i>	Difuzioni në continuum
<i>Java e tretë:</i>	Trajtimi atomistik i difuzionit
<i>Java e katërt:</i>	Kinetika e reaksionit kimik
<i>Java e pestë:</i>	Teoritë e reaksionit kimik
<i>Java e gjashtë:</i>	Teoria e gjendjes tranzite
<i>Java e shtatë:</i>	Teknikat eksperimentale për monitorimin e shpejtësisë së reaksionit
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi i pare intermediar
<i>Java e nëntë:</i>	Kinetika e proceseve gaz-ngurtë.
<i>Java e dhjetë:</i>	Transformimet fazore lëng-ngurtë dhe ngurtë-ngurtë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ngurtësimi
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Reaksionet ne tretësira.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kinetika e disa reaksioneve të vecanta
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Kinetika e reaksioneve katalitike
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë intermediar
Plani i dizajnuar për ushtrime	
<b>Java</b>	Ushtrimet që do të mbahen
<i>Java e parë:</i>	Përcaktimi i shpejtësisë dhe rendit të reaksionit nga të dhënat eksperimentale
<i>Java e dytë:</i>	Teknikat eksperimentale për monitorimin e shpejtësisë së

	reaksionit
<i>Java e tretë:</i>	Përcaktimi i ligjit të shpejtësisë dhe konstantës së shpejtësisë të reaksionit të zërthimit të peroksidysulfatit
<i>Java e katërt:</i>	Përcaktimi i Ea të reaksionit të zërthimit të peroksidysulfatit
<i>Java e pestë:</i>	Përcaktimi i ligjit të shpejtësisë dhe konstantës së shpejtësisë të reaksionit të dekolorimit të Kristal violet-tit (Methylrosaniline chloride)
<i>Java e gjashtë:</i>	Përcaktimi i Ea të reaksionit të dekolorimit të Kristal violet-tit ( Methylrosaniline chloride)
<i>Java e shtatë:</i>	Metoda kinetike e pseudo-rendit për reaksionin e oksidimit të alkoolit izopropilik.
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësimi i parë intermediar
<i>Java e nëntë:</i>	Përcaktimi i Ea të reaksionit e oksidimit të alkoolit izopropilik.
<i>Java e dhjetë:</i>	Përcaktimi i shpejtësisë dhe rendit të reaksionit të jodizimit të acetoneit.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i Ea të reaksionit të reaksionit të jodizimit të acetoneit.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kinetika e reaksionit në mes të tretësirës së KI dhe FeCl <sub>3</sub>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kinetika e reaksionit të vitamins C
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Kinetika e adsorbimit të joneve Cu <sup>2+</sup> në argjilë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë intermediar.

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime si dhe aktiviteti gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve.

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>FSHMN, Departamenti i Kimisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Korrozioni</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Rregullt</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E enjte 10:30, Salla nr.2,</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Dr. Fetah PODVORICA</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:fetah.podvorica@uni-pr.edu">fetah.podvorica@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Në këtë kurs studentët do të mësojnë për llojet e ndryshme të korrozionit dhe metodat për mbrojtjen e metaleve nga korrozioni.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
	Moduli është përgatitur me qëllim të njohjes së studentëve të kimisë, inxhinierisë kimike, shkencave materiale dhe të metalurgjisë me të dhënat fundamentale teorike dhe praktike të korrozionit dhe mbrojtjes prej tij. Studentët do të mësojnë bazat e elektrokimisë, do të jenë në gjendje të njohin dallimin në mes celulave galvanike dhe elektrolitike dhe atyre të korrozionit, do të njohin parimet teorike të cilat e shpjegojnë korrozionin e metaleve dhe materialeve, do të njohin llojet e ndryshme të korrozionit, do të njohin metodat për matjen e shpejtësisë së korrozionit, do të njohin mënyrat e llogaritjes së shpejtësisë së korrozionit, do të mësojnë edhe për pasivizimin e metaleve.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	
	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. të njoh parimet e avancuara të termodinamikës dhe kinetikës së procesve elektrokimike.</li> <li>2. të kuptoj informacione më të reja në lëminë e korrozionit të metaleve dhe materialeve</li> <li>3. të dij me bërë matje me metodat më të reja të shpejtësisë së korrozionit të metaleve.</li> <li>4. të mësoj teorinë për pasivizimin e metaleve.</li> <li>5. të njoh metodat elektrokimike të cilat përdoren për mbrojtjen e metaleve nga korrozioni.</li> </ol>
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të</b>	

<b>nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	3	6
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
	ligjërata, seminar, diskutim, punë në grupe .		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	Vlerësimi i parë: 15% Vlerësimi i dytë 15% Angazhimi në ushtrime 15% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 50% Total 100%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	1. T. Ohtsuka, A. Nishikata, M. Sakairi, K. Fushimi. Electrochemistry for Corrosion Fundamentals. Springer Briefs in Molecular Science, 2018.		
<b>Literatura shtesë:</b>	2. D.E.J. Talbot, J.D.R. Talbot. Corrosion Science and Technology CRC Press Taylor & Francis Group, USA 2020.		
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>			
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>		
<b>Java e parë:</b>	Bazat e elektrokimisë së korrozionit		
<b>Java e dytë:</b>	Termodinamika e reaksioneve të korrozionit, reaksionet katodike në korrozion.		
<b>Java e tretë:</b>	Paraqitja grafike e ekuilibrit elektrokimik, Diagramet e Pourbaix-it		

<b>Java e katërt:</b>	Kinetika elektrokimike e reaksioneve në një gjysëm celulë
<b>Java e pestë:</b>	Kinetika elektrokimike e reaksioneve në gjysëm celula të lidhura
<b>Java e gjashtë:</b>	Korrozioni galvanik
<b>Java e shtatë:</b>	Korrozioni i llojit aktiv-pasiv, metalet dhe legurat
<b>Java e tetë:</b>	Testi i parë vlerësues
<b>Java e nëntë:</b>	Pasiviteti i metaleve, aliazheve dhe gjysëmpërçuesve.
<b>Java e dhjetë:</b>	Inhibitorët
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Metodat elektrokimike për mbrojtje nga korrozioni: mbrojtja anodike dhe katodike
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Matjet elektrokimike të shpejtësisë së korrozionit
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Korrozioni lokal
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Korrozioni në temperatura të larta.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Testi i dytë vlerësues

**Plani i dizajnuar i ushtrimeve:**

**Ushtrimet që do të zhvillohet**

Ndërtimi i diagrameve të Pourbaix-it

Llogaritja e drejtzave të Tafel-it prej matjeve elektrokimike

Matja e shpejtësisë së korrozionit të hekurit në mjedis ujor acid me anë të voltametrisë

Matja e shpejtësisë së korrozionit të zinkut në mjedis ujor acid me anë të impedancës

Matja e shpejtësisë së korrozionit të hekurit në mjedis ujor neutral me anë të voltametrisë

Matja e shpejtësisë së korrozionit të zinkut në mjedis ujor neutral me anë të impedancës

Pasivizimi i imponuar i metaleve

Pasivizimi spontan i metaleve

Mbrojtja katodike

